



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/0064**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani dhe Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së OE “Pro Medical SH.P.K.” kundër njoftimit për dhënie të një kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-se” me nr. të prokurimit: “206-23-4215-1-1-1”, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë më 21/03/2024, mori këtë:

### **Vendim**

**1. Refuzohet**, si e pabazuar ankesa e “Pro Medical Sh.P.K.” me nr. 2024/64 , e datës 21.01.2024 lidhur me aktivitetin e “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-se” me nr. të prokurimit: “206-23-4215-1-1-1”, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë.

2.Mbetet ne fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues - Ministria e Shëndetësisë lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit, për LOT 10 dhe LOT 14.

3.Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me 04.05.2023 “Pro Medical Sh.P.K.” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente

mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-se” me nr. të prokurimit: "206-23-4215-1-1-1".Ndërsa me datë 27.12.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE “Meditech Sh.P.K.”

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës :për LOT 10: 50,000 euro, për LOT 14: 37,500 euro

Me 03.01.2024, OE “Pro Medical Sh.P.K.” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 11.01.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 21.01.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Pro Medical Sh.P.K.” me nr. 64/2024 lidhur me aktivitetin “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-se” me nr. të prokurimit: "206-23-4215-1-1-1".

*-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Pro Medical Sh.P.K.” janë parashtruar si në vijim:

**Pretendimi i parë (I):** “Pretendimi i pare ankimor për Lot 10 - Furnizim me pajisje mjekësorë për Kl. e Oftalmologjisë Ne kemi vënë re sa komisioni vlerësues ka bërë disa gabime/devijimeve në vlerësimin e ofertës tonë, dhe dëshirojmë tju japim shpjegime të sakta dhe të plotësisht të qartësuar për arsyet e këtyre gabimeve nga komisioni vlerësues ne jemi eliminuar edhe pse AK/NJK kanë dhe sqarime me datë 26.05.2023. AK ne Letër Standarde për OE Eliminuar 27.12.2023 është cekur arsyet eliminimit si më poshtë për LOT 10. Arsyet e refuzimit tonë nga AK kanë ndryshuar në krahasim me ato të përfshira në vendimin e datës 27.12.2023. Disa nga pikat e theksuara nga AK tani janë përshkruar nga PSH, ku ankesa jonë me nr. 641 është aprovuar nga OSHP pasi pajisja jonë është vlerësuar si më e avancuar sesa kërkesat e AK. Ky vlerësim është konfirmuar edhe përmes sqarimeve të AK, duke renditur cilat standardet janë përmbushur më mirë nga pajisja jonë, siç është shpjeguar nga AK, "or better, or higher. Pra ne kemi ofertuar me pajisje me avancuar ku kemi plotësuar pika e cekur nga AK si ato cekur me lart dhe ne baze mundësi që OE te ofertoj me pajisjet edhe te avancuar pra better ot higher, kurse pika 7 kemi dorëzuar deklaratën tek garancioni si ka qene cekur me poshtë. Po AK duhet te ketë parasysh DT dhe sqarimet e dhëna e jo analiza dhe komentime lidhur me pajisjen nga komisioni vlerësuese, sepse është hera e parë që kemi vërejtur një konstatim nga komisioni vlerësues dhe kjo ka krijuar dyshime se te gjitha LOTO që kanë qenë Kl. e Oftalmologjisë janë fituar nga OE

“Meditech” ku kemi vërejtur se te gjitha specifikacionet teknike ne DT dhe pajisjet e ofertuar nga OE “ Meditech” janë identike qe kjo ka krijuar dyshime se specifikacionet teknike janë bërë ndoshta ne bashkëpunim me OE “ MEDITECH” dhe Kl. e Oftalmologjisë. Sa i përket konstatimit të komisionit nuk qëndron dhe kjo nuk është e qëndrueshme për shkak se në sqarime keni dhënë mundësi te ofertohe me teknologji me te mire dhe avancuar. Arsyetimi juaj për nevojën e trajtimit manual të pacientëve për shkak të aplikimit të syve me joystick nuk është i qëndrueshëm. Duhet të përdorni teknologjinë e avancuar, e cila mundëson lëvizjen automatike të syrit dhe kokës. Prandaj, besoj se qëllimi është që të ofrojmë një klinësi dhe avancim të pajisjeve, dhe jo shfrytëzimin e pajisjeve manuale. Tonometër automatik pa kontakt TonoVet Me teknikën e gjurmimit 3D, matje të shumta IOP mund të bëhen me një prekje të vetme. Ndjekja automatike 3D pra gjurmimi automatik dhe shtrirja automatike me një trokitje të lehtë të bebëzës. Besoj se komisioni e ka parasysh se koka vendoset ne pajisjet me poshtë dhe e vendosur edhe ne mjekre si pike reference ku ne baze te lëvizjes se kokës , lëvizë pajisja ne mënyrë automatike me 3D ose opsionin manual siç është cekur ne foto më poshtë. Opsioni me lëvizjes para, pas, lart dhe poshtë po thuaj se me justik por vetëm me avancuar. Arsyet e eliminimit të tonë (Pro Medical) nga komisioni vlerësues i AK nuk qëndron sepse në vijim do të argumentoj se arsyeja e eliminimit është i paarsyeshëm dhe i pa i bazuar për: Joystick Peratio ose Funkcioni i levës (shqip). Ne për LOT 10 me pajisjen e ofertuar kemi plotësuar dhe tejkualuar kërkesa e AK pra NJK sepse kemi ofertuar me pajisjet shumë avancuar se sa kërkesat teknike në DT, pra ne kemi ofertuar me pajisje më të avancuara pra siç është cekur edhe në sqarime AK or better, or higher pra pajisja jonë e ofertuar për LOT 10 pra Crystalvue TonoVue ka - Operim në formën Joystick nga ekрани siç kemi cekur më lartë, sepse pajisja është me një ekran prekës LCD 10.1 inç dhe të gjitha veprimet bëhen me një prekje të vetme në mënyre manual pra klasike apo automatike, pra pajisja jonë është me e avancuar e cila të gjitha veprimet i kryen shumë thjesht dhe më precizitet të lartë, se me Operim me Joystick, si kemi theksuar me lart, pra pajisja jone që kemi ofertuar është me e avancuar dhe të gjitha veprimet kryen vetëm në një mënyrë shumë të thjeshtë dhe të saktë, duke e bërë kështu Operimin me Joystick të panevojshëm, pra pajisja jonë është Fully Automated Non-Contact ose shqip Plotësisht i automatizuar pa kontakt pra e teknologjia me të avancuar. -Arsyet e eliminimit të OE Pro Medical nga komisioni vlerësues i AK nuk qëndron sepse në vijim do të argumentoj se arsyeja e eliminimit është i paarsyeshëm dhe i pa i bazuar. Ju lutem shikoni mënyrë e operim ne video e dorëzuar ne Ankesë. Duke i plotësuar dhe tejkualuar këto specifikacione teknike, parametra dhe duke marr parasysh këto performancat të teknologji më të avancuar, pajisja jonë ofron një performancë të jashtëzakonshme dhe ndryshon për më mirë sfidën e të kryerit të shërbimeve me pajisje të fundit teknologjike në këtë fushë. Me teknologjinë më të fundit , pajisja jonë ofron një performancë më të përparuar dhe e përmbush me lehtësi kërkesat e shërbimeve lidhur me pajisjen ne LOT 10. Në lidhje me LOT 10, pajisja jona e ofertuar ka plotësuar dhe tejkualuar kërkesat e NJK dhe AK. Ne kemi ofertuar pajisje që janë shumë më të përparuara se kërkesat e përcaktuara në DT, kurse komisioni vlerësues nuk e ka vlerësuar këtë përparësi dhe pse e ka bërë të ditur në sqarimet e tyre se pranohen pajisjet me më mirë, ose më lart (better, or higher) pajisja jonë për LOT 10 Duke pasur parasysh këto përfitime të pajisjeve të avancuara, kërkojmë nga AK/NJK që të kryejë një vlerësim profesional në përputhje me sqarimet e datës 26.05.2023 dhe të konsiderojë performancat më të përparuara që ofron pajisja jonë. Ky vlerësim do të siguronte një përputhje të qartë midis avancimeve teknologjike dhe nevojave të interesit publik shëndetësor. Ne baze të dëshmive, provave dhe faktet ne si OE duhet të rekomandohemi për kontratë për LOT 10, kurse ju keni Anuluar LOT 10 edhe pse ne kemi plotësuar specifikacione teknike dhe kemi tejkualuar ato.

”

**Pretendimi i dytë (II)** : “Pretendimi i dytë ankimor për Lot 14 - Furnizim me pajisje mjekësorë për Kl. e Oftalmologjisë Ne si OE për LOT 14 nuk kemi pranuar nga AK LS me 21.08.2023 për tenderues të pasuksesshëm, por në bazë raportit të vlerësimit ne jemi të pasuksesshëm kurse AK ka rekomanduar për kontrate OE “ Meditech” për LOT 14 në kundërshtime me Neni 59 të LPP. Kurse ne rivlerësim neve ne eliminom me arsyetim të cila janë në kundërshtime me sqarimet e dhëna nga AK kurse te gjeturat ne raporti dhe vendimin e OSHP me numër protokollit Nr.671 nuk e merr edhe pse OE i rekomanduar nuk ka dorëzuar fare katalogu për disa pajisjet përcjellëse. Ne vendimin e pare te AK ne kemi qenë të pasuksesshëm (cekur më poshtë) kurse ne vlerësim AK na eliminin me arsyetime te cilat vlen vetëm për ne me arsyetimin se mungoj edhe pse OE rekomanduar i mungoj spcifikacionet teknike si: Sipas Aneksi 1 Specifikimet Teknike të Detyrueshme Tavolinë e motorizuar, që i përshtatet lartësia e markës së njëjtë me rrota të vogla me frena, me këllëf paketimi (1), përshtatës elektrik (1) - 1 set Karrige rrotulluese - 1 copë. Karrige pacienti me përshtatje të lartësisë - 1 copë. E pajisur me bateri që rimbushen - UPS: autonome  $\geq 30$  minuta Por AK nuk vrenë këtë tek OE rekomanduar sepse është favorizuar nga AK dhe NJK. Sa i përket siç keni cekur ju Vertex distance prej 10 mm ju e jeni ne dijeni se një paramater i tillë nuk ka ndonjë rëndësi kurcial si duke marr parasysh se ka distancat tjera standarte tjera, por ju duhet te keni parasysh se OE i rekomanduar nuk ka te cekur as cilin model ka ofertuar edhe pse kriter ka qene ne DT si “Kërkesa 2. Operatori ekonomik te prezantoj katalogun (broshurën) e pajisjeve te ofruara dhe te nënvizohen ne mënyrë te qarte produktet dhe specifikat teknike te ofruara. Nëse ofrohet broshura, duhet te specifikohet linku i web faqes” Kurse OE i rekomanduar ka ofertua me dy model me poshtë edhe duke mos e përfshirë as pajisjet përcjellëse sipas Aneksin 1. Kurse je keni cekur se mungon Fog control por pasije jone këtë e ke ne mënyrë ku ndryshohet ky opsion shiko me poshtë Fog control por pasije jone këtë e ke ne mënyrë ku ndryshohet ky opsion shiko me poshtë pra na manual i perdorimit eshte kjo foto edhe dëshmitë e dorëzuar: 9 / 11 Shiko email pra dëshminë Email për LOT 14 ose manualin e përdorimit për këtë pajisje. Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve- AK nuk ka respektuar LPP gjatë vlerësimit të ofertës të OE të rekomanduar për kontratë , në vijim do ilustrojmë se pse ky OE duhet të eliminuar dhe jo rekomanduar për kontratë siç ka vepruar AK. Specifikacionet teknike dhe kërkesat e AK për LOT 14 kanë qenë cekura si më poshtë: Loti 14- Auto-Kerato-Refraktometër - Ups, tavolinë e motorizuar, karrige për kontrolluesin dhe pacientin – 5 copë. Sipas Aneksi 1 Specifikimet Teknike të detyrueshme Aksesorë Tavolinë e motorizuar, që i përshtatet lartësia e markës së njëjtë me rrota të vogla me frena, me këllëf paketimi (1), përshtatës elektrik (1) - 1 set Karrige rrotulluese - 1 copë. Karrige pacienti me përshtatje të lartësisë - 1 copë. E pajisur me bateri që rimbushen - UPS: autonome  $\geq 30$  minuta Kurse OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar për Aksorë asnjë katalogu, specifikacion teknik, foto apo ndonjë dëshmi se çfarë ( pozicioni 1) tavoline ka ofertuar elektrike / mekanike / manual, (pozicioni 2 dhe 3) çfarë karriga dhe çfarë ( pozicioni 4) UPS , por ka dorëzuar vetëm një deklarata e cila nuk mund të merr për bazë nga AK sepse deklarata nuk mund te zëvendësoj katalogu apo specifikacionet teknike në rastin konkret, pra deklarate mund te pranohet vetëm ne rastin konkret si më poshtë ju lutem shikoni A02 udhëzues Nr-001 2023 për prokurimin publik, pra OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar asnjë informacion, katalog, specifikacione

teknike, foto etj. Pra komisioni vlerësues ka bërë vlerësim shabllon pra pasur asnjë ide se çfarë aksesore do të dorëzohet kurse AK dhe NJK duhet të ketë parasysh se këto kanë kosto financiare ku ky këto aksesore kanë vlerë deri 2,000 deri 2,400. Euro set kurse 5 copa x 2,000 euro(min) =10,000 euro min me çmimi minimal. Nëse me deklaratë e OE rekomanduar se ka ofertuar me aksesore pranohet nga AK apo PSH me një deklaratë të tillë kjo praktike mund të praktikohet tash e tutje për aksesore mund të dorëzohet vetëm një deklaratë bllanka , por ne besoj se kur kërkohet katalogu me specifikacionin teknik në Dosjen Teknike, ai duhet të dorëzohet, sepse shihet se AK ka përdoruar dy standarde të ndryshme për ne ka bërë vlerësim në hollësi dhe si qëllim ka pasur eliminim të tone, kurse anën tjetër, në rastin e OE të favorizuar, nuk është aplikuar një standard i tillë, edhe pse nuk ka specifikacione teknike për pajisjet si UPS, tavolina e motorizuar dhe aksesore përcjellës dhe mungon katalogu. Megjithatë, AK vazhdon të rekomandojë për kontratë, pasi është favorizuar nga AK në OE 10 / 11 Por A02\_Udhëzues Nr-001\_2023 për prokurimin publik jep sqarim të qartë se si duhet të veprohet AK në rastet e tilla. Pra OE i rekomanduar për kontratë për LOT 14 është në kundërshtim me Neni 59.4 citim "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit" Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik 40.2 citim " Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do të jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesat të përcaktuara paraprakisht, kriteret ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve" Edhe 40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur: a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit; b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit; c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit. Pra siç kemi cekur më lart dhe në bazë të LPP Neni 59.4 , Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik 40.2 dhe A02 Udhëzues Nr-001 2023 për prokurimin publik duhet të eliminuar nga AK e jo të rekomandohet për kontratë, dhe njëherit AK duke e rekomanduar për kontratë këtë OE bie ndesh me Neni 7 të LPP sepse vërehet se ne jemi diskriminuar si në LOT 10, LOT 14 dhe LOT 18. Vlen të theksohet se gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave, kemi vënë re se të gjitha specifikacionet teknike ishin identike me ato të ofruesit të produkteve "Meditech". Kjo ngre dyshime se në procesin e përgatitjes të specifikacioneve nga NJK ka favorizuar OE "Meditech" ku dhe pjesën dërmuese është edhe rekomanduar për kontratë. Në bazë të dëshmive, provave dhe faktet ne si OE duhet të rekomandohemi për kontratë për LOT 14, kurse OE i rekomanduar duhet të eliminohet sepse ka ofertuar dhe nuk ka dorëzuar fare katalogu, specifikacionet teknike apo ndonjë foto për Aksesore të kërkuara në Aneksi 1 Specifikimet Teknike Të Detyrueshme."

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Neni 1, 7, 59, 60 si dhe Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik 40. Kërkojmë nga OShP që të marrë Vendimi i Aprovohet si e bazuar kërkesa për rishqyrtim dhe lënda të kthehet në Rivlerësim, dhe gjatë fazës së rivlerësimit AK të marrë

parasysh sqarimet tona për LOT 10 dhe 14.

**Përgjigje ne kërkesën për rishqyrtim:** “Përgjigja e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore te OE për Lot 10:Profesionistet shëndetësor nga Klinika e Oftalmologjisë, pas shqyrtimit te pretendimeve tuaja ankimore, kane konstatuar se pretendimet tuaja ankimore janë te pa bazuara dhe se oferta juaj nuk i plotëson specifikat teknike te kërkuara ne Dosje te Tenderit, për pikat si ne vijim:Pika 4 - Funksionimi i levës është kërkuar (me Joystick) - Nuk e keni ofruar fare.Pika 9 - Monitori nuk ka rrotullim majtas 20 - 30 shkalle, si dhe pjerrësi vertikale 30 - 40 shkalle. Ekрани i ofruar është fiks, i pa lëvizshëm.Pika 7 - Nuk e keni ofruar Softuer me përditësime të pakufizuara dhe antivirus me përditësime të pakufizuara. Nuk keni ofruar asnjë deklaram për përditësimet e kërkuara ne tender.Ekрани i ofruar nga ana juaj është pa ngjyra (bardh e zi) ndërsa ne specifikacion te tenderit është kërkuar LCD me ngjyra. Përgjigja e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore te OE për Lot 14:Profesionistet shëndetësor nga Klinika e Oftalmologjisë, pas shqyrtimit te pretendimeve tuaja ankimore, kane konstatuar se pretendimet tuaja ankimore janë te pa bazuara dhe se oferta juaj nuk i plotëson specifikat teknike te kërkuara ne Dosje te Tenderit, për pikat si ne vijim:Pajisja e ofruar nuk e posedon specifiken Vertex distanca prej 10mm, e cila ka qene kërkesë e DT - pika 9. Sa i përket pretendimit tuaj ku keni cekur se Vertex distance prej 10 mm nuk ka ndonjë rendësi kruciale, ky pretendim është plotësash i pa bazuar, sepse ne aspektin profesional kjo specifike e kërkuar ka rendësi shumë te madhe te matjet e dioptrive te mëdha, për shkak te saktësisë se matjes.Sa i përket specifikes Fog control qe pretendoni se e keni plotësuar, ne katalogun e ofruar nga ana juaj nuk vërehet një specifike e tille, katalogu nuk ka qartësi për tu vërejtur kjo specifike, si dhe nuk është e specifikuar as tekstualisht as ne table kjo komponentë ne katalog.Gjithashtu fotografia e prezantuar ne ankesën tuaj nuk korrespondon me fotografën e katalogut te ofertës. Gjithashtu teksti i me sipërm i ofruar ne ankesën tuaj, nuk ekziston ne katalogun e ofruar ne tender.”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 26.01.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues ndërsa me datën 30.01.2024 ka autorizuar ekspertin teknik për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 64/2024, ndërsa me datë 12.02.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues si dhe ekspertit teknik me nr. 2024/64 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti teknik/shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues, pa ofruar asnjë provë apo arsye rreth mos pajtimit të tij.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

*- Administrimi dhe vlerësimi i provave -*

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Pro Medical Sh.P.K.” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/64 ka vlerësuar si në vijim:

**Konstatimi i parë (I):** “Të gjitha pretendimet ankimore të cilat kanë të bëjnë me aspektin teknik, për të njëjtat është përgjigjur eksperti teknik si më poshtë. Eksperti teknik sqaron se OE Pro Medical Sh.P.K është i papërgjegjshëm për Lotin 10 pasi që nuk i plotëson specifikat teknike të detyrueshme të kërkuara në dosje të tenderit për pajisjen e ofruar pasi i mungojnë specifikat e kërkuara në DT të cilat janë shume të rëndësishme për ekzaminim: 1 Funksionimi i leves Joystick mungon gjë që pamundëson ndjekjen e syrit të pacientit. Monitori nuk ka rrotullim majtas 20 – 30 shkalle- Ekрани është i palëvizshëm. 3 Është kërkuar Ekрани LCD me ngjyra e cila e qartëson diagnostifikimin e sëmundjeve të syrit të cilin OE e ka bardh e zi. 4 Nuk posedon softwerin me përditësime dhe antivirus opsionin. Andaj AK ka vepruar konform nenit Neni 59 të LPP, duke rekomanduar si oferte të papërgjegjshme ofertën e OE Pro Medical Sh.P.K, për mosplotësim të specifikave teknike të pajisjeve të ofruara..”

**Konstatimi i dytë (II) :** OE “Pro Medical” Sh.P.K është i papërgjegjshëm për Lotin 14 pasi që nuk i plotëson specifikat teknike të detyrueshme të kërkuara në dosje të tenderit për pajisjen e ofruar pasi nuk i posedon specifikat. Pajisja nuk e posedon specifikën Vertex distanca prej 10 mm e cila vështirëson precizitetin e matjes së dioptrisë së ekzaminuesit. 2. Fog Control që qartëson vizualitetin e ekzaminimit të dioptrisë së ekzaminuesit. Sa i përket pretendimeve të tjera të radhitura të OE Pro Medical Sh.P.K., se OE i rekomanduar për kontrate nuk e ka prezantuar katalogun e nënvizuar dhe pajisjet përcjellëse, këto pretendime janë të paqëndrueshme sepse OE ka prezantuar komplet specifikat teknike të pajisjeve. Ka ofruar katalogun e pajisjes në fjalë, ndërsa për aksesoret shtese ka prezantuar deklaratë me shkrim se të gjitha pajisjet përcjellëse (aksesoret) do të ofrohen konform kërkesave të dosjes së Tenderit. Pra vlen të përmendet se kriteri për katalogun/broshurën ka qene për pajisjet e jo për aksesoret shtese, siç janë: karriget, tavolina, UPS, etj, pasi që në dosje të tenderit për këto aksesore nuk janë kërkuar specifikime të detajuara. OE i rekomanduar ka deklaruar me shkrim dhe është i obliguar që gjatë liferimit të pajisjeve, do të sjellë edhe pajisjet shtese sipas siç janë kërkuar. Oferta financiare e OE të rekomanduar përfshinë pajisjet dhe aksesoret shtese. Vendimi për rishqyrtim (rivlerësim) nga AK është i bashkangjitur në ekspertizë. Duke marr parasysh përgjigjet e dhëna nga eksperti teknik, sa i përket pretendimit se ka nene të shkelura nga ana e AK-së, atëherë rezulton që të njëjtat nuk qëndrojnë.

Eksperti teknik, duke u bazuar në të gjeturat, krahasimet, faktet, dokumentet e shqyrtuara dhe të cekura në këtë ekspertizë, dhe pasi ka ekzaminuar dëshmitë e ofruara nga OE ankues vlerëson se kërkesa e OE ankues është e pabazuar për LOT 10 dhe LOT 14. Prandaj, eksperti teknik në baze të sqarimeve të lartcekura, i propozon panelit shqyrtues që të aprovohet si e pabazuar ankesa e OE ankues për LOT 10 dhe LOT 14 dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

*- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -*

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit,

konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues si dhe ekspertit teknik mendimet e tyre janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tyre me rastin e vendosjes .

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur ankesa e operatorit ekonomik është e pabazuar.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur tëmbetët në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për LOT 10 dhe 14, lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-se” me nr. të prokurimit: "206-23-4215-1-1-1". Komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional dhe po ashtu përgjegjës sipas nenit 59.1 cituar të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës respektivisht anulimin, bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimi ankimor i OE ankues është i pabazuar dhe refuzohet, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e ekspertit.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur në konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik - shëndeti i qytetarëve.



Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues  
**Vedat Poterqoi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - PRO MEDICAL SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: